



## K O N T R A T E

### PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### " R O Z A F A T "

#### 1. PALB.

Ne kuptimin e kesaj kontrate per krijimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar e cila qe ketu dhe me pas referohet si shoqeri pale jane :

1. Myfit Zhabjaku, i biri Muesse dhe Hyrijes, i dtlindjes 6.7.1952, lindur e banues ne Shkoder, lagjen "Ahmet Haxhija", Rruga "Shaban Huti" Nr.68.
2. Beqir Krymi, i biri Xhemalit dhe Hajrazes, i dtlindjes 23.5.1949, lindur e banues ne Shkoder, lagjen "Vasil Shanto", Rruga "Çlirimi" pallati 1144/1/14.

#### 2. QELLIMI.

Qellimi i kesaj kontrate eshte krijimi i shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ROZAFAT". Kjo shoqeri do ta kete seline ne qytetin e Shkodres, lagjen "Ahmet Haxhija", rruga "Shaban Huti" Nr.68.

#### 3. OBJEKTI.

Objekti i veprimtarise se shoqerise percaktohet ne nenin 2 te statutit te shoqerise qe i bashkelidhet kesaj kontrate.

#### 4. AFATI.

- 4.1 Kjo kontrate ndermjet palove lidhet per nje afat prej



15 vjetesh. Ne perfundim te ketij afati palet mund te zgjasin  
kete kontrate ose te lidhin nje kontrate te re.

4.2 Shoqeria mund te mbaroje edhe para ketij afati, sipas  
menyres dhe kushteve te percaktuara ne nenin 13 te statutit.

4.3 Ne rast se ndonjera palet kerkon zgjidhjen e kontrates  
ajo eshte e detyruar te njoftoje palen tjeter te pakten  
6 muaj perpara.

4.4 Ne rast se njora palet kerkon zgjidhjen e kontrates dhe  
largimin nga shoqeria, pala tjeter ka te drejten e parablorjes  
per pjesen e pasurise se te pares.

4.5 Nese shoqeria do te mbaroje veprimtarine e saj, pasuria e  
shoqerise do tu ndahet paleve ne perputhje me kontributin  
e tyre.

5. DATA EBEKTIVE.

Kjo kontrate do te jete efektive qe nga ditapkur pasi te  
jete firmosur nga palet, mbi bazen e saj, te statutit dhe  
kerkeses, te jete plotesuar e gjitha procedura ligjore dhe  
te jete bere regjistrimi i shoqerise ne regjistrin tregtare  
te Gjykates se Kreshit Tirane dhe te jete fituar zotesia  
per te vepruar si person juridik.

6. KAPITALI THEMELTARE I SHOQERISE.

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj me ane te  
kontributit te te dyja paleve.  
Palet bien dakort qe persa kohe nuk do te vendosin ndrysho  
te ruajne raportin e kontrbuteve ne kapitalin themeltare  
te shoqerise si me poshte :

- 1. Myfit Zhabjaku                    50 %
- 2. Beqir Krymi                        50 %

Vlera e kapitalit themeltare do te jete 100 000 leke-

7. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE.



Palet kane te drejte dhe detyrim per te marre pjese ne administrimin e shoqerise, per te siguruar fitime nga veprimtaria e saj, dhe per tu informuar ne çdo kohe per gjendjen ekonomiko-financiare te shoqerise. Te drejtat, detyrimet dhe kompetencat konkrete jane percaktuar ne statutin e shoqerise, te cilin palet ne funksionet e ortakeve e miratuan.

8. JURIDIKSIONI.

- 8.1 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet paleve që nuk mund të zgjidhet me pajtim, i referohet për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Tiranë.
- 8.2 Shoqëria duke qenë person juridik i ligjuhem sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me këtë kontratë, statutin dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

P A L E T

Myfit Zhabjaku

Beqir Krymi



## STATUTI

### I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### "ROZAFAT"

#### 1. HYRJJE.

- 1.1 Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ROZAFAT" qe qe ketu dhe me pas referohet si shoqeri, krijohet mbi bazen e kapitalit dhe inisiatives te :
1. Myfit Zhabjaku, i biri Musase dhe Hyrijes, i dtlindjes 6.7.1952, lindur e banues ne Shkoder, Lagjen "Ahmet Haxhija", Rruga "Shaban Huti" Nr.68.
  2. Beqir Krymi, i biri Xhelalit dhe Hajrazes, i dtlindjes 22.5.1949, lindur e banues ne Shkoder, Lagjen "Vasil Shanto", Rruga "Çlirimi" pallati 1144/1/14.
- 1.2 Shoqeria krijohet dhe e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me normat e ketij statuti, kontrates dhe legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.
- 1.3 Kjo shoqeri, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltare.

#### 2. OBJEKTI.

- Objekt i veprimtarise se shoqerise do te jete :
- hapja e entit bogues "ROZAFAT" per botimin e librave te autoreve shqiptare dhe te huaj.
  - Nxjerrja e gazetave private dhe shteterore duke ju permbajtur ligjit per shtypin dhe standarteve te

*JA*

*Blz*

te njohura evropiane, duke mos bere propogande luftenxitose, fashiste dhe antikuehtetuese.

- Tregtimi i botimeve te ndryshme brenda dhe jashte vendit.
- Transporti i botimeve te ndryshme brenda dhe jashte vendit.
- Tregtimi dhe botimi me shumice e pakice te materialeve te kancelerise si letor, boje, fletore, blloqe te madhesive te ndryshme, kalendare, revistave etj.

### 3. HMNI, SELIA, TERRITORI.

- 3.1 Kjo shoqeri do te qehet "ROZAFATA, Shoqeria do te fitoje personalitetin e saj juridik qe nga data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Shkoder.
- 3.2 Shoqeria do te keto qendren e saj ne qytetin e Shkodres. Selia e shoqerise do te jeto ne lagjen "Ahmet Haxhija" Rruga "Shaban Huti" Nr.68.
- 3.3 Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne te gjithe territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mund te krijojë degë ose perfaqësi edhe ne rretho te tjera te Shqipërisë ose jashte saj.

### 4. KAPITALI THEMELTARE I SHOQERISE.

- 4.1 Kapitali themeltare i shoqerise perbehet nga kontributi i themeluesve ne shumen prej 100.000 lekesh.

1. Myfit Zhabjaku 50 %

2. Beqir Krymi 50 %

- 4.2 Kapitali themeltare do te depozitohet ne nje banke te qytetit te Shkodres para fillimit te aktivitetit te shoqerise.
- 4.3 Kapitali themeltare mund te shtohet ose pakësohet ne varësi te rezultateve dhe nevojave dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi

- 4.4 Kapitali themeltare mund te transferohet jashte shoqerise ose te lihet peng ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 4.5 Kapitali themeltare eshte lirisht i transferueshem ne rruge trashegimie, Bashkeshortet, paraardhesit dhe pasardhesit, mund te behen ortakëq nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltare dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 4.6 Kapitali themeltare mund te shtohet edhe me pranimin e ortakëveq te tjere.

#### 5. FONDET E SHOQERISE,

Shoqeria percakton fondet e meposhteme :

1. Fondin qarkulues.
2. Fondin rezerve.
3. Fonde te tjera, te cilat mund te jene te nevojshme per realizimin e veprimtarise se saj.

- 5.2 Masa e secilit fond dhe menyra e perdorimit te tij percaktohet nga asambleja e ortakëveq.

#### 6. NDARJA E FITIMEVE,

- 6.1 Pas perballimit te detyrimeve, takeve, tatimeve, pagave te punonjeseve, shpenzimeve te ndryshme, ortakëveq u mbetet ne dispozicion fitimi neto.
- 6.2 Fitimi neto mund te perdoret per zgjerimin e kapitalit themeltare te shoqerise si dhe per shtimin e fondeve te shoqerise te percaktuara ne kete statut.
- 6.3 Fitimi neto mund te perdoret edhe per qollime te tjera.

#### 7. ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE DHE ADMINISTRIMI I SAJ.

- 7.1 Organi me i larte drejtues i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.
- 7.2 Asambleja e ortakeve si rregull mblidhet nje here ne tre muaj. Ajo mund te mblidhet edhe me shpesh kur nje gje te tille e kerkon njeri nga ortaket.
- 7.3 Asambleja e ortakeve qahet e mbledhur kur marrin pjese te dy ortaket.
- 7.4 Per mbledhjen e asamblese, ortaket duhet te njoftohen te pakten 15 dite perpara me leter rekomande ku te jete shenuar edhe rendi i dites.
- 7.5 Vendimet e asamblese merren me shumice votash kur ne statut nuk eshte parashikuar ndryshe. Çdo ortak ka te drejten e votes ne perputhje me perqindjen e tij ne kapitalin themeltare.
- 7.6 Ndryshimet ne statutin e shoqerise vendosen me unanimitetin e te dy ortakeve.
- 7.7 Asambleja e ortakeve zgjedh administratorin nga radhet ose jo te ortakeve.
- 7.8 Miraton politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.
- 7.9 Miraton emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel.
- 7.10 Shqyrton bilancin vjetor dhe percakton kuotat e fondeve te ndryshme, si dhe fitimin qe do tu ndahet ortakeve ne perputhje me kontributin e tyre.
- 7.11 Vendos per krijimin e degëve dhe perfaqesive si dhe miraton krijimin e ndermarrjeve e shoqerive te perbashketa me persona te tjere juridike e fizike.
- 7.12 Vendos per marrjen e kredive sipas nevojave te shoqerise.
- 7.13 Vendos me unanimitet per shnderrimin e shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri te llojeve te tjera.
- 7.14 Miraton ose realizon marredhenjet me te rendesishme te shoqerise me persona te tjere juridike apo fizike.
- 7.15 Miraton çmimet e shitjes dhe te sherbimeve.
- 7.16 Miraton pagat per personolin e punesuar ne shoqeri.

7.17 Miraton rregulloret per sektore te vecante te voprintarise se shoqerise.

8. KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT.

8.1 Administratore i shoqerise "ROZAFAT" eshte Myfit Zhabjaku.

8.2 Administratori kujdeset per funksionimin normale e te perditeshem te aktivitetit ekonomiko-financiare te shoqerise ose te pjeseve te vecanta te aktivitetit te saj.

8.3 Prgatit dokumentacionin dhe relacione te ndryshme per gjendjen ekonomike-financiare te shoqerise, sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet per shqyrtim asamblese se ortakeve.

8.4 Koodinon voprintarine e personelit te punesuar ne shoqeri.

8.5 Ndjek probleme te shoqerise me organe te ndryshme shtetere.

8.6 Shqyrtton oferta dhe prgatit kontrata te cilat ia paraqet per miratim asamblese se ortakeve.

9. KOHEZGJATJA E SHOQERISE.

Kjo shoqeri krijohet per nje afat prej 15 vjetesh.

10. MENYRA E PERFAQESIMIT.

Shoqeria perfaqesohet nga administratori i saj ne te gjitha marrredhenjet e ndryshme juridiko-civile. Ajo mund te perfaqesohet edhe nga ndonje person tjetet i paisur me prokure te posacme ose autorizim te vecante.

11. MARRREDHENJET E PUNESIMIT.

Çdo person do te punesohet ne shoqeri mbi bazen e kontrates se punes te lidhur ndermjet tij dhe administratorit te shoqerise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

12. PERGJEGJESIA E PUNONJESVE DHE KONFIDENCIALITETI.

Çdo person i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjose per kryerjen e detyres. Ai eshte i dotyruar te permbuhe

*DR*

*18/6*



detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes si dhe vendimet e organeve drejtuese! Ai eshte gjithashtu i detyruar te ruaje karakterin e fehte te dokumentacionit, te informacionit, te pervojave te shkombyer si dhe te cdo materialit konfidencial.

13. MBARIMI I SHOQERISE.

13.1 Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te organit te saj drejtues ne rast se aktiviteti nuk rezulton fitimprures, per shkak te forces madhore e per shkak te tjera ligjore.

13.2 Shoqeria mund te mbaroje edhe me ane te riorganizimit nepermjet formave te thithjes, bashkimit dhe ndarjes.

13.3 Gjate fazen se likuidimit te shoqerise ortakët kane te njejten pergjegjesi.

14. DISPOZITA TE FUNDIT.

14.1 Viti financiar e shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Viti i pare financiar e perfundon me 31 dhjetor 1996.

14.2 Pauria e shoqerise mund te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve.

14.3 Shoqeria do te keto vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles percaktohet nga asambleja e ortakëve.

O R T A K E T

Myfit Zhabjaku



Beqir Krymi



MINISTRIA E DREJTESISE

" N O T E R I A "

NR. 2324  
1181

.Tirane, me 14.7.1996

V E R T E T I M

Vertetohet se sot u paraqiten para moje noteres te quajturit Myfit Zhabjaku, i biri Musase dhe Hyrijes, i dtlindjes 1962, lindur e banues